



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 14, datë 25.02.2020.

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Vau-Dejës, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e **z.Gezim Gjergj Luka** banore i Qytetit Vau-Dejës banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri me dt.22.01.2020 nga Buxheti i Bashkisë i vitit 2020 si dhe Buxheti i Vitit 2020 në Ministrinë e mbrojtjes, programi “Mbrojtja Civile” Shkak i dëmtimit të kësaj shtëpie është djegia nga zjarri, e vlerësuar nga specialistet e M.Z.SH-së (zjarrfikësve).

Baza Ligjore

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji për prefektin Nr.107/2018, Ligji nr.45/2019 “për mbrojtjen Civile , VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimit Nr.3 datë 28.12.2016 i KM “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016 ,në shkresën **Nr. 287 prot, datë 14.02.2017** të Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të banesave (drejtoria teknike) dërguar Këshillit të Qarkut Shkodër për çmimet për zëra punimesh të vitit 2016, shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orëndive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.92 dt.24.12.2019 mbi “Miratimin e Buxhetit të Vitit 2020”,pas diskutimit u miratua sipas nenit 55 pika 3 e Ligjit 139/2015 ,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e familjes së shtetasit **Gezim Luka** banorë i Bashkisë Vau-Dejës për mbështetje financiare të tij, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri me dt.22.01.2020.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau-Dejës.